



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE ✓

Nr. 07 Prot.,

Tiranë, me 06 . 1 . 2025

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të jashtëm

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE**  
Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË SË KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME  
JASHTË**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

**Specialist**, Njesia e Pasagjerit, Sektori Operativ Antitrafik, Drejtoria Antitrafik, pranë Departamentit Operativo Hetimor, Kategoria e Pagës III-b, 2 (dy) pozicione pune

***Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:***

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim penal të formës së prerë
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional në Shkencat Ekonomike, Juridike, Shkencat Kompjuterike/ Inxhinjeri Elektronike/Informatike/ Informatik Ekonomike/ Teknologji Informacioni/ Inxhinjeri Telekomunikacioni.
7. Përvojë pune deri në 1 (një) vit
8. Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

***Përshkrim përgjithësues për pozicionin:***

1. Njesia e informacionit paraprak të pasagjerit mund të shkëmbejë të dhëna me struktura të tjera doganore apo shtetërore, me kompetenca në fushën e zbatimit të ligjit, për mallra, mjete apo subjekte, me qëllim parandalimin dhe goditjen e shkeljeve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi kundër trafiqeve.
2. Ajo bashkëpunon me agjenci, institucione dhe aktorë të tjerë, përfshirë ata ndërkombëtarë, të cilët kanë detyrime ligjore ose që janë të angazhuar në luftën kundër trafiqeve dhe zbatimin e masave ndaluese, kufizuese.
3. Njesia e informacionit paraprak të pasagjerit realizon koordinimin e veprimeve të strukturave policore në nivel qendror, transmetimin e pa ndërprere të informacionit, drejtimin e veprimeve policore për parandalimin e emigracionit të parregullt, përmirësimin e kontrollit kufitar, parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, në përputhje me legjislacionin specifik, si dhe bazuar në Kodin Doganor
4. Lexon dhe kupton legjislacionin dhe aktet administrative që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti ose jo me kompetencat e Drejtorisë, bashkëpunon me Departamentin për sqarime dhe interpretime, informohet për ndryshimet/amendimet më të fundit që prekin punën e Drejtorisë Antitrafik siguron zbatimin e duhur të ligjit nga vartësit.
5. Siguron një zbatim të drejtë, të ligjshëm dhe të paanshëm të procedurave që janë kompetencë e postit dhe përgjigjet drejtpërsëdrejti për respektimin rigoroz të tyre.
- 7- I raporton Shefit të Sektorit dhe nëpërmjet tij Drejtorit të Drejtorisë Antitrafik për ecurinë e aktiviteteteve dhe projekteve të Grupit.
- 8- Ushtron kompetencat e deleguara me ligj apo nga eprorët administrative, në mënyrën më të përshtatshme dhe të efektshme, në respektim të formulimit dhe frymës së ligjit dhe duke patur si synim përmbushjen e objektivave operative të ADSH.

***Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:***

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe Lista e Notave të noterizuara (*Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*)
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penaliteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Letër referencë dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës

12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

**Procedura e konkurimit** do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Përvojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

### **Rezultatet e konkurimit**

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 16 . 9 . 2025 ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra Sekretari/Protokollit.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Gent Gazheli**

